



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISË



Programi: **Master**

Drejtimi: **Histori**

Lënda: QYTETI MESJETAR

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Dr. Ferit DUKA, Ph.D.c. Andi REMBECI
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS: (15 javë- 2 leksione 1 seminare në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/ Semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Qëllimi i kësaj lënde është të informojë studentët me format urbane në periudhën mesjetare. Lënda do të organizohet e ndarë në dy pjesë: a) qyteti në periudhën mesjetare dhe b) qyteti në periudhën osmane. Do të shqyrtohen çështje të jetës politike, shoqërore, ekonomike, kulturore dhe urbanistike të qyteteve mesjetare. Duke kuptuar elementet themelore të qytetit mesjetar, studentët mund të perceptojnë më mirë sistemin e funksionimit të qytetit. Studentët do të shqyrtojnë materialet bibliografike dhe arkivore për të fituar aftësi të reja për qasje dhe interpretime të sakta të lëndës përmes dëshmimeve dokumentuese.

Studimi i qytetit mesjetar lidhet jo vetëm me shqyrtimin e fenomeneve urbane në vetvete, por ai përbën edhe një mjet të rëndësishëm për të kuptuar drejt shoqërinë shqiptare të Mesjetës në përgjithësi. Shpërngulja e kryeqendrës së Perandorisë Romake nga Roma në Kostandinopojë në shek. IV është tregues edhe i përzgjedhjes politike për kalimin e qendrës së rëndësës në Lindje, ku tradita urbane ishte e konsoliduar. Nën këto kushte, roli i qyteteve vijoi të ishte përcaktues dhe ndikoi në formimin e karakteristikave të caktuara strukturore të hapësirës bizantine. Venitja e qytetit dhe e civilizimit antik pas shek. VI ishte faktor dhe, njëkohësisht, rezultat i kalimit nga Antikiteti në Mesjetë. Si rrjedhojë, kjo periudhë është padyshim e një rëndësie të veçantë për përcaktimin e karakterit të shoqërisë mesjetare në Perandorinë Bizantine. Ndaj dhe rëndësi të veçantë për këtë periudhë merr shqyrtimi i zhvillimit urbanistik dhe social të qytetit shqiptar si brenda sferës bizantine e sllave të dominimit ashtu edhe sferës së dominimit perëndimor (venedikas, etj.). Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet karakteristikave të zhvillimit institucional dhe urban të qyteteve në kuadër të principatave shqiptare, si dhe rolit politik që ato luajnë në kohën e dhënë.

Një kthesë vendimtare shënohet në historinë e shqiptarëve me vendosjen e sundimit osman (shek. XV), gjë gjeti pasqyrim të qartë para së gjithash në fizionominë, format dhe ritmet e zhvillimit ekonomik, urbanistik e arkitekturor të qyteteve. Gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve do të shqyrtohen tiparet e reja që fiton qyteti i periudhës osmane, vendi dhe roli i tij në kontekstin e përgjithshëm të jetës politike, shoqërore, kulturore dhe fetare në Shqipërinë osmane, si dhe raportet e qyteteve me vijimësinë dhe ndryshimin si komponentë thelbësorë të procesit historik.

Një vend të rëndësishëm në suazat e këtij kursi do të zënë analizat dhe interpretimet rreth dinamikës së ndryshimeve me karakter social-ekonomik në qytete gjatë shekujve osmanë, rolit të qyteteve si në lidhjet ekonomiko-tregtare midis trevave shqiptare, ashtu edhe midis këtyre të fundit me rajonin e Ballkanit dhe Europën Perëndimore. Vëmendja do të përqendrohet gjithashtu edhe në rolin dhe funksionet e reja të qyteteve në kuadër të administrimit osman të tokave

shqiptare, institucionet që u ndërtuan dhe vepruan në qytete, si dhe rolin dhe rëndësinë që patën qytetet në zhvillimet kulturore, arsimore dhe urbanistike të arealit shqiptar në periudhën osmane.

Temat e leksioneve:

1. Qyteti gjatë kalimit nga Antikiteti i Vonë në Mesjetën e hershme Bizantine.
2. Qyteti shqiptar gjatë periudhës së Mesjetës I (shek. VI-XI).
3. Forma, zhvillimi, organizimi dhe fizionomia e qytetit mesjetar.
4. Qytetet mesjetare dhe veçoritë e tyre.
5. Qyteti shqiptar gjatë periudhës së Mesjetës II (shek. XI-XIV).
6. Zhvillimi, organizimi dhe fizionomia.
7. Qyteti dhe fshati shqiptar gjatë Mesjetës.
8. Pushtimet osmane dhe qytetet shqiptare.
9. Tiparet e reja të zhvillimit ekonomik të qytetit shqiptar: zejtaria.
10. Veprimtaria tregtare në qytete gjatë shekujve osmanë.
11. Lidhjet qytet-fshat në Shqipërinë osmane.
12. Qytetet dhe procesi i islamizimit.
13. Roli i qyteteve shqiptare si qendra kulturore dhe arsimore: rasti i Voskopojës.
14. Zhvillime urbanistike dhe arkitekturore të qytetit shqiptar të periudhës osmane.
15. Roli i qyteteve në lidhjet ekonomiko-tregtare të viseve shqiptare me botën e Jashtme.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI: 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 5-10 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

Literatura e detyrueshme për studentin:

Milan Šufflay, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë: kryesisht në Mesjetë*, Tiranë: Onufri 2009.
Zija, Shkodra. *Qyteti shqiptar gjatë rilindjes kombëtare*. Tirana: 1984.

Literatura plotësuese:

2000 vjet Art dhe Kulturë *Kishtarë në Shqipëri*, bot. KOASH, Tiranë 2003.

Aleksandër Meksi, *Arkitektura mesjetare në Shqipëri, shek. VII-XV*, bot. 8 Nëntori, Tiranë 1983.

Anthony Bryer, "The Structure of the Late Byzantine Town: Dioikismos and Mesoi," in *Continuity and Change in Late Byzantine and Early Ottoman Society*, ed. Anthony and Heath Lowry (Birmingham–

David Nicholas, *The Evolution of the Medieval World. Society, Government and Thought in Europe, 312-1500*, Longman, London & New York 1992.

Ennio Concina, *La città bizantina*, Roma-Bari, Laterza 2003.

Ferit Duka, *Berati në kohën osmane (shek. XVI-XVIII)*, Tiranë: Toena, 2001

Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (Studime dhe dokumente)*, Tiranë: UET Press, 2009

George Ostrogorsky, "Byzantine Cities in the Early Middle Ages", *Dumbarton Oaks Papers* 13 (1959), fq. 45-66.

George Ostrogorsky, *Historia e Perandorisë Bizantine*, bot. Dituria, Tiranë 2007.

Henri Pirenne, *Medieval Cities: Their Origins and the Revival of Trade*, Princeton University Press, 1956.

Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, vëll. I, bot. Toena, Tiranë 2002 (Pjesa e dytë – Mesjeta).

Injac Zamputi, "Autonomitë e qyteteve shqiptare të prinipales së Balshajve dhe pasojat negative të pushtimit venedikas. Fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV", *Studime Historike* 3 (1980).

Injac Zamputi, "Autonomitë e qyteteve shqiptare të prinipales së Balshajve dhe pasojat negative të pushtimit venedikas. Fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV", *Studime Historike* 3 (1980).

Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas 1392-1478*, Tiranë 1988.

Lucia Nadin (a cura di), Pëllumb Xhufi (trad), *Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469*, Roma : Viella, 2002

Machiel Kiel, Arkitektura osmane në Shqipëri (përkth. Olta Vrioni), Tiranë: AIITC, 2012

Machiel Kiel, Arkitektura osmane në Shqipëri (përkth. Olta Vrioni), Tiranë: AIITC, 2012

Milan Šufflay, *Situata e Kishës në Shqipërinë paraturke: zona e depërtimit ortodoks në "digën" katolike*, Shkodër: Botime françeskane, 2013

Oliver Jens Schmitt, *Arbëria venedike: (1392-1479)*, Tiranë: K & B, 2007

Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI (Studime dhe dokumente)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, 1984

Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, 1988

Spiro Shkurti, "Gjurmime në jetën ekonomike të qyteti mesjetar", *Kultura popullore* 1-2 (2000).

Spiro Shkurti, "Vendbanimet fshatare dhe ekonomia bujqësore në Shqipërinë mesjetare", *Etnografia Shqiptare* 17 (1997).

Warren Treadgold, *A History of the Byzantine State and Society*, Stanford 1997.

Zef Mirdita, Ndue Ballabani (red.), *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren; Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar, 1998.

Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)*, Tiranë, 1973

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. As. Dr. Eva TAFILI

Tiranë, 2016